

S T A T U T I**I SHOQERISE “ BESTRONG ALBANIA ” SHPK****I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI
SELIA, DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.**NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ **BESTRONG ALBANIA** ” SHPK eshte krijuar sipas Aktit te Themelimit qe i bashkalidhet ky *statut* perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket:

TAMAS LIPOCZI i biri i Ferenc, i dt 12.05.1975, lindur dhe banues ne Hungari, identifikuar me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.742845CE.

ANDRAS KERTESZ i biri i Andras, i dt 10.03.1975, lindur dhe banues ne Hungari, me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.591461CE.

ARNOLD MESZAROS i biri i Jozsef, i dt 08.05.1976, lindur dhe banues ne Hungari, me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.354719HE.

DAVID NAGY i biri i Janos, i dt 02.06.1994, lindur dhe banues ne Hungari, identifikuar me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.241635HE.

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, Kodin Civil, Ligjin nr. 9901 datë 14. 04. 2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, dhe ne perputhje me dispozitat e ketij *statuti*.

Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne QKB.

NENI 3

Emertimi i shoqerise eshte “ BESTRONG ALBANIA ” SHPK

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ushtrimi i aktivitetit privat si vijon: *Tregtia me shumice dhe ndermjetesimi tregtar –aktivitet te ndermejetesimit ne tregtineme shumice*

-ndermjetesim me tregtine e tekstileve

-ndertimi –punime perfundimtare

Punime te tjera perfundimtare

-Pergatitja e kantierit te ndertimit

Shembja e ndertimeve dhe sistemi i terrenit

Germimet dhe sondazhet

-Tregtia me pakice per produkte te tjera ne dyqane te specializuara

-Tregtia me pakice jashtë njesive tregtare
Tregtia me pakice me korrespondence (telefon, katalogeve, internet etj)
-Organizimi i konferencave, shfaqjeve tregtare, konsulence biznesi.

NENI 5

Shoqëria mund të ndryshojë emertimin, seline, kohezgjatjen, pjesemarrjen e kuotave, administratorin, objektin e veprimtarisë së saj e të kryejë veprime të tjera sipas ligjit me vendim të asamblese së ortakeve.

NENI 6

Shoqëria e ka selinë në Qerret, Kavaje, objekti A2, ndertese 5 kate+papafingo, apartamenti nr.A 24/2

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të ortakeve të shoqërisë.

Keto organizohen dhe administrohen me vete dhe ushtrojnë veprimtari me pale të treta, në emër të shoqërisë.

Nese dega ose zyra e përfaqësimit do të krijojë një faqe interneti, ato do të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.

Shoqëria ka vulen e vet me emrin e saj.

NENI 7

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të paktuar.
Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë me vendim të ortakeve të shoqërisë për motive të bazuara në ligj.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke (njëqind mijë).

Kapitali themeltar është ndarë në 4 (kater) kuota, me vlerë 2500 leke të reja të kapitalit secila

Çdo kuota i takon e drejta e një vote.

NENI 9

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga kontributi i ortakeve si vijon:

Ortaku **TAMAS LIPOCZI** me 1 kuota e barabartë me 25000 leke (25 % të kapitalit) të kapitalit fillestar.

Ortaku **ANDRAS KERTESZ** me 1 kuote e barabarte me 25000 leke (25 % te kapitalit) te kapitalit fillestar.

Ortaku **ARNOLD MESZAROS** me 1 kuote e barabarte me 25000 leke (25 % te kapitalit) te kapitalit fillestar.

Ortaku **DAVID NAGY** me 1 kuote e barabarte me 25000 leke (25 % te kapitalit) te kapitalit fillestar.

NENI 10

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashëgimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 11

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete me miratimin paraprak te ortakeve, duke respektuar te drejten e parablerjes se ortakeve dhe duke zbatuar dispozitat ligjore te parashikuara nga Legjislacioni ne fuqi.

NENI 12

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet te vertetohet me Akt-Noterial.

III. ASAMBLEJA E PERGJITHSHME, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOMPETENCA DHE KONTROLI I SHOQERISE

NENI 13

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise.

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Asambleja e ortakeve.

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per ceshtjet:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- Ndryshimin e statutit,
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdësve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit

- pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit nga administratoret apo nga ortakët e percaktuar ne perputhje me nenin 84 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te asetevete shoqerise dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te asetevete te shoqerise.

Thirrja e asamblese behet nepernjete nje njoftimi ose postes elektronike, i cili duhet te permbaje vendin, daten e rendin e dites, jo me vone se 7 dite para mbledhjes se asamblese.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

KUORUMI

Per marrjen e vendimeve, qe kerkojne shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar , sipas nenit 87 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht ,votojme me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve ne piken 3 te nenit 88 te ketij ligjit.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ,ajo mbidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja merr vendim per:

- Vleresimin e veprimtarise se tij
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- Ngritjen e nje padie ndaj tij
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja

- Vendimet per emerimin dhe shkarkimin e administratorit merren me shumice te thjeshte te votave.

NENI 14

ADMINISTRATORI

Shoqeria administrohet nga administratore qe mund te jene persona fizike te zgjedhur nga ortakët e shoqerise ose edhe jo ortakë.

Administrator i shoqerise eshte emeruar z .ANDRAS KERTESZ.

Administratori do te qendroje ne detyre per nje periudhe kohe 5 vjecare, me te drejte riemerimi, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet fuqive qe i jane percaktuar ne kete statut dhe ne ligj.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakeve me shumicen e thjeshte te votave.

Tagrat e perfaqsimet te administratorit dhe cdo ndryshim I tij njoftohen per regjistrim prane QKB

KOMPETENCAT

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave, që ligji ia jep shprehimisht asamblese të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve, që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin, që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statusi, që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit nuk i lejohet të marre hua te shoqëria, të jape pëlqimin në emer të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzënës apo te garantojë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Ne rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

NENI 15

PERGJEGJESITE

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e mareveshjeve te pamiratuara nga ortaket qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere merreveshjen, per te perballuar ato ne menyre individuale .

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryrjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Ortaket kane te drejte te ndjeke ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit, qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Neni 16

Administratori ka te drejte e detyrohet :

-Te kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare te percaktuar nga Asambleja e pergjithshme .

-Te perfaqesoje shoqerine tregetare.

-Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.

-Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ia paraqit keto akte ortakut te vetem (ortakeve) per shqyrtim.

-Kryen regjistrimet dhe I dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, prane QKB, sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Bisnesit.

-Ndjek probleme te shoqerise ne marredhenie me persona fizik e juridik ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

-Ti propozoje ortakeve per miratim strukturen e aparatit te shoqerise dhe krijimin e organeve tjera te nevojshme per realizimin e objektivave te shoqerise.

NENI 17

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i cili emerohet dhe shkarkohet nga ortaket sipas ligjit.

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollin periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga Asambleja e pergjithshme.

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

NENI 18

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

NENI 19

Llogarite vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarine e vitit financiar te hartuara nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar miratohet nga ortaket.

NENI 20

Bilanci vjetor i veprimtarise se shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

NENI 21

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise mbasi zbriten te gjitha shpenzimet e kryera, ortaket vendosin per qellimin e perdorimit si: per investim, nxitjen ekonomike, reklame tregtare, shperndarje te fitimit, etj duke respektuar fondin e rezerves ligjore.

NENI 22

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimeve dhe te disponimit lirisht te pasurise se saj dhe te ndaje fitimin e realizuar ne baze te kuotave te kapitalit qe zoteron seicili ortak .

NENI 23

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ajo i mbulon nga fondi rezerve ose nga shumat suplementare.

NENI 24

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat dhe mbrojtjen e pasurive te saj nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

V. PUNESIMET NE SHOQERI**NENI 25**

Per punonjesit qe do te punesohen marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe vecanerisht te kodit te punes.

NENI 26

Shoqeria merr persiper te derdh rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUIDIMI**NENI 27**

Prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj., Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare", Kur plotesohet afati i caktuar per ustrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast asanblea merr vendim me shkrim ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim ".

NENI 28

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e marrjes se vendimit per prishjen e saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaket emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te shoqerise.

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit te emertuar nga Asanblea e shoqerise , bazuar ne nenin 191 pika 2, te ligjit 9901 dt.14.04.2008.

Nese Asanbleja nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar rruond t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

NENI 29

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria emerone me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i

emerimit parashikon se ata veprojnë vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkerisht te drejtat e detyrimit sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryejne veprime te nje kategorie te posacme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakeve dhe administratorit.

NENI 30

Afati i emerimit te likuiduesit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e QKB.

NENI 31

Likuiduesi eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

Te drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
 2. Likuiduesi mund te kryejte edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
 3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.
- Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave.

Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga asambleja e pergjithshme.

NENI 32

Perfundimi i Likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c' regjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 'Per Qendren Kombetare te Regjistrimit'

NENI 33

BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimnine e saj disa shoqerive te reja.

Asambleja e pergjithshme e shoqerise, qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfiton pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para, vlere e te cilit nuk mund te kaloje 10% (per qind) te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise, qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimnise ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell

njekohesisht per ortaket e shoqerive, qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

VII. KUSHTET E TJERA

NENI 34

Te gjitha vendimet e ortakeve rregjistrohen ne liber te veçante qe mbahet ne seline e shoqerise.

NENI 35

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kavaje.

NENI 36

Ky statut u perpilua ne gjuhen shqipe ne kater kopje me fuqi te barabarte seicila, pasi lexohet nga ortaket e shoqerise, ata deklaruan se e kuptuan e pranojne dhe e nenshkruajne rregullisht ne baze te ligjit.

Kavaje me 21.09.2020

ORTAKET

TAMAS LIPOCZI

Tamas Lipoczi
A y

ARNOLD MESZAROS

ARNOLD MESZAROS

L m

ANDRAS KERTESZ

Andras Kertesz

DAVID NAGY

DAVID NAGY

N y

Perklyes

Sándor Kertész

Sándor Kertész

Sándor Kertész

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FREDERIK J. TENGU



DATE 21/09/2020
NR REP 2501

VËRTETIM NËNSHKRIMI



Sot, më datë 21.09.2020 para meje Noter FREDERIK J. TENGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Kavaje, LAGJIA NR.1, JOSIF BUDO, NR.98, 18/271, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Tamas Lipoczi, atësia Ferenc, lindur në Hungari dhe banues në Hungari, lindur më 12/05/1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karte identiteti te shtetit te Hungarise 742845CE , .

ANDRAS KERTESZ, atësia Andras, lindur në Hungari dhe banues Hungarilindur më 10/03/1975, gjendja civile "Fusha_GjendjaCivile", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karte identiteti te shtetit te Hungarise nr. 591461CE , .

Arnold Meszaros, atësia Jozsef, lindur në Hungari dhe banues në Hungari, lindur më 08/05/1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karte identiteti te shtetit te Hungarise nr.354719HE , .

David Nagy, atësia Janos, lindur në Hungari dhe banues në Hungari, lindur më 02/06/1994, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karte identiteti te shtetit te Hungarise nr.241635he .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit,

STATUTI i shoqërisë "BESTRONG ALBANIA" sh.p.k i redaktuar me vullnetin e lire e te plote te tyre, dhe qe e kane nenshkruar secili personalisht ne pranine time noterit, ne kete zyre noterie.

Akti ju perkthye ne gjuhen Hungareze nga shtetsi **SANDOR KOCZKAS** i dt 26.01.1963, lindur dhe banues ne Hungari, identifikuar me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.556586PA, i cili ka nenshkruar ne akt me ate cilesi i autorizuar dhe i pranuar nga palet ne prani te tyre dhe meje noterit ne kete zyre noterie, ne perputhje me ligjin 110/2018.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
FREDERIK J. TENGU